

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve: M. K. dhe A. G. që të dy nga Prizreni, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamentit të Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.2959-1/2016 të datës 07.12.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në praninë e prokurorit të shtetit Fatos Ajvazi, të akuzuarve, mbrojtësve të tyre avokatëve B. K. dhe D. M. nga Prizreni dhe të dëmtuarve Z. N. e M. N. nga Prizreni, me datë 09.10.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

M. K. nga i ati F. dhe e ëma G. e lindur F., i lindur më datë *data e lindjes...* në C. – shteti Zvicrës, tani me banim në Prizren rruga ... pa nr., ka të kryer shkollën fillore, autolimar, i pamartuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike.

A. G. nga i ati H. dhe e ëma Sh. e lindur B., i lindur më datë *data e lindjes...* në Prizren ku edhe tani jeton rrugën ... pa nr., ka të kryer shkollën fillore, elektrikist, i pamartuar, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

JANË FAJTOR

Me datë 14.10.2016 rreth orës 19:00, në Prizren rrugën ..., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ia marrin pasurinë e luajtshme të dëmtuarve Z. N. dhe M. N., me marrëveshje paraprake, heqin me forcë pengesat në shtëpinë e mbyllur, në atë mënyrë që e shfrytëzojnë, kohën dhe momentin e përshtatshëm dhe mos prezencën e anëtarëve të familjes, i afrohen shtëpisë së dëmtuarve, kapërcejnë murrin e oborrit dhe shkojnë drejtë oborrit të pasme të shtëpisë dhe me forcë me mjet të përshtatshëm e hapin dritaren e kuzhinës në katin e parë, hyjnë brenda në kat dhe vazhdojnë drejt për në katin e dytë të shtëpisë dhe fillojnë të demolojnë dhomat e fjetjes, ashtu që e thyejnë derën e dhomës së fjetjes të dëmtuarës Z. N. dhe nga aty marrin stoli ari të cilët i ka pasur e dëmtuara në ruajtje, pasi që stolit i takonin motrës së saj, po në këtë kat e demolojnë edhe dhomën e fjetjes të dëmtuarit M. N. dhe nga aty marrin stolit e arit të cilët i takonin bashkëshortes së tij, kështu nga stolit marrin: 7 (shtatë) unaza, 5 (pesë) putlia, 6 (gjashtë) lira, 5 (pesë) hallka dore, 4 (katër) zinxhirë të trashë, 1 (një) zinxhir në gjatësi prej 2 metra, 3 (tri) qafore, 2 (dy) zinxhirë të dorës, 2 (dy) unaza, 1 (një) qafore, me ç'rast të dëmtuarve i shkaktojnë dëm të konsiderueshëm material.

Kësodore në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK.

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 43, 45, 46, 73, 83 dhe nenit 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK:

G J Y K O N

Të akuzuarin M. K.

- me **DËNIM BURGIMI** në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite, në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 18.11.2016 deri më datë 04.04.2017 dhe arresti shtëpiak prej datës 04.04.2017 e deri më datë 09.10.2017, me ç'rast masa e paraburgimit me datë 09.10.2017 është vazhduar deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

- me **DËNIM ME GJOBË** në lartësi prej 2000 € (dy mijë euro), të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim i njëjti do të zëvendësohet me 100 (një qind) ditë dënim burgu duke llogaritur për 20 € një ditë burg.

Të akuzuarin A. G.

- me **DËNIM BURGIMI** në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite, në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 18.11.2016 deri më datë 04.04.2017 dhe arresti shtëpiak prej datës 04.04.2017 e deri më datë 30.05.2017 kur masa e arrestit shtëpiak është zëvendësuar me masën e paraburgimit dhe me datë 09.10.2017 është vazhduar deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

- me **DËNIM ME GJOBË** në lartësi prej 2000 € (dy mijë euro), të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim i njëjti do të zëvendësohet me 100 (një qind) ditë dënim burgu duke llogaritur për 20 € një ditë burg.

Të dëmtuarit Z. N. dhe M. N. që të dy nga Prizreni rruga ... nr..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Të akuzuarit obligohen solidarisht të paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa i akuzuari M. K. obligohet të paguaj në emër të shpenzimeve shtesë edhe për ekspertizën për shëndetin mendor shumë prej 367.09 € si dhe për prezantimin e anëtarit të komisionit – ekspertit nga ekipi i ekspertëve në seancë të paguaj shumë prej 40.88 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor secili prej tyre veç e veç të paguaj nga 50 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.2959-1/2016 të datës 07.12.2016, kundër të akuzuarve: M. K. dhe A. G. që të dy nga Prizreni, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK.

Prokurori shtetit Fatos Ajvazi në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar nën numrin PP/II.nr.2959-1/2016 të datës 07.12.2016, kundër të akuzuarve M. K. dhe A. G., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK. Pasi që gjatë shqyrtimit gjyqësor me rastin e administrimit të provave dhe sipas ekspertizës së psikiatrisë të datës 10.02.2017 përpiluar nga grupi i ekspertëve të forenzikës Dr. J. Z. psikiatër i forenzikës, Dr.sc. G. H. neuro psikiatër, Dr. Sh. H.

psikitar dhe Dr. V. B. psikiater, nga konstatimi në ekspertizë është vërtetuar se i akuzuari M. K., nuk vuan nga çrregullimi i kualitetit psikotik, nuk është konstatuar prapambetje mendore, në momentin e kryerjes së veprës penale me të cilën ngarkohet. Aftësia e të kuptuarit dhe të kontrollit së veprimeve të veta ka qenë e ruajtur, është i aftë të konsultohet me personat tjetër përfshirë edhe mbrojtësin e tij, po ashtu i njëjti sipas këtij konstatimi mund të merr pjesë në shqyrtime gjyqësore dhe tek i njëjti nuk janë gjetur elementet e natyrës psikiatrike të cilat do të ndikonin në validitetin e deklaratave të tij. Andaj duke pasur parasysh këtë rrethanë nga deklaratat e akuzuarit M. K. dhënë në polici, prokurori e veçanërisht ajo e dhënë në shqyrtimin e datës 02.10.2017, nga e njëjta dhe dekoratat tjera të cekura më parë u vërtetuar fakti se i akuzuari M. K., natën kritike veprën për të cilën ngarkohet ka kryer në bashkëveprim me të akuzuarin A. G.. I akuzuari para prokurorisë dhe gjykatës ka përshkruar dhe vërtetuar të gjitha veprimet e kryerjes, si të tija personale ashtu edhe të akuzuarit A. G.. Prokurori i shtetit theksoj se në disa pjesë të deklaratave ka pasur disa ndryshime, por kjo ka mundur të jetë për shkak të kalimit të kohës, presioneve dhe frikës që ka pasur nga i akuzuari A. G.. Mirëpo vlen të theksohet se u vërtetua vendi i kryerjes, mënyra e kryerjes së veprës penale dhe pasoja të cilët janë fakt vendimtar në këtë çështje penale. Sa i përket pasojës dhe dëmeve të shkaktuar tek të dëmtuarit nga veprimet e të akuzuarve këtë e vërtetuan dy të dëmtuarit të dëgjuar edhe në cilësinë e dëshmitarit. Gjatë shqyrtimi gjyqësor janë dëgjuar edhe dëshmitarët e propozuar nga pala mbrojtëse, mirëpo dëshmitë e tyre nuk janë të besueshme në disa pjesë, pasi në përmbajtje nuk kanë asnjë lidhje kauzale me veprën për të cilën ngarkohen dy të akuzuar. Andaj prokurori konsideroi dhe vlerësoi se nga provat të cilat janë administruar gjatë shqyrtimeve gjyqësore secila veç e veç dhe gjithë së bashku, vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë se të akuzuarit M. K. dhe A. G., në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen dhe nuk ka asnjë rrethanë e cila mund të përjashtoj nga përgjegjësia penale. Andaj i propozoi gjykatës që të njëjtit të shpall fajtor për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par. 1.1 e lidhur me nenin 31 të KPK.

E dëmtuara Z. N. në fjalën përfundimtare theksoj se e mbështet fjalët e prokurorit të shtetit, mirëpo sa i përket dëmit i cili është shkaktuar, kërkon nga gjykatat që për këtë fakt të udhëzoj në kontest të rregullt civil.

I dëmtuari M. N. në fjalën përfundimtare theksoj se e mbështet fjalët e prokurorit të shtetit dhe si palë e dëmtuar parashtron kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i akuzuarit M. K. – Avokat B. K. në fjalën përfundimtar theksoj se prej fillimit të procedurës e gjerë në seancën e fundit organet e ndjekjes nuk kanë shfaqur interes për zbardhjen në tërësi të kësaj çështje penale. Nga fakti se kjo çështje penale mbështetet në deklaratat e akuzuarit M. K. dhënë në polici, prokurori, para ekspertës si dhe në gjykatë. Të gjitha provat tjera tregojnë se ngjarja ka ndodhur dhe kur ka ndodhur, mirëpo me asnjë provë tjetër nuk lidhen të akuzuarit me veprën penale. Andaj në këtë drejtim mbrojtja bëri elaborimin e deklaratave të akuzuarit dhe atë duke u nisur nga deklarata e parë dhënë në polici, i akuzuari M. K. ka deklaruar se ngjarja ka ndodhur pas orës 20:30 minuta dhe aty ka shkuar me dhunë e cila është shkaktuar nga dy shokët e tij A. G. dhe R. B.. Tani bëhet pyetja pse A. G. është i akuzuar në këtë çështje penale, ndërsa për R. B. nuk është ndërmarr asnjë veprim. Kjo deklaratë e akuzuarit bie poshtë me vetë faktin se ngjarja ka ndodhur diku nga ora 18:00 deri në ora 18:20 minuta, me një kohë të rrufeshme. Deklarata e dytë dhënë në prokurori i akuzuari ka thënë se veprën penale e ka kryer së bashku edhe me dy shokë të tjerë E. dhe E., për të cilët po ashtu nuk është hapur asnjë hetim. Me këtë deklaratë po ashtu ka shtuar se ka gjetur një çantë me para prej 1.000 €, të cilën deklaratë prokuroria e vlerësoj si provë më e rëndësishme, ndërsa nga provat del se në shtëpi nuk është vjedhur asnjë çantë me para,

parashtrahet pyetja si do të mund të falet besimi kësaj deklarate kur ka dallim esencial me të gjitha provat tjera materiale si dhe me ngjarjen e ndodhur. Në deklaratën e tretë dhënë para ekspertëve mjekësore i akuzuari ka deklaruar se në atë shtëpi ka gjetur një çantë me para në shumën prej 5.000 € dhe në bazë të kësaj deklarate ekspertët e kanë nxjerr ekspertizën se i akuzuari nuk ka ngecje mendore. Dhe në fund deklarata e fundit dhënë në gjykatë e cila më së shumti përshtatet me ngjarjen që ka ndodhur dhe përshtatet me të gjitha provat tjera materiale dhe me deklaratën e dëmtuarve dhënë në shqyrtimit gjyqësor. Sipas mbrojtjes të gjitha këto deklarata dhe prova janë në kundërshtim me njëri tjetrin.

Më tej mbrojtja shtjelloj edhe rrethanat personale të akuzuarit me qëllim që ta njohim mirë të njëjtin, duke parashtruar fakte dhe atë, gjatë tre muajve të paraburgimit M. K. nuk ka vizuar askush nga familja dhe shoqëria. Kjo vërteton faktin se M. K. është person i braktisur nga familja e tij dhe nga gjithë shoqëria. Në një situatë dhe rrethanë të tillë i akuzuari me aftësitë e tij intelektuale shkon dhe kërkon ndihmë nga organet e ndjekjes i tregon atyre që ka bërë disa vepra që nuk ka dashur ti bëjë sepse ka qenë i detyruar, kështu ka pranuar gabimin e tij, mirëpo ai tradhtohet nga të gjitha institucionet. Si rezultat i kësaj akuzohet se ka kryer veprën penale në bashkëkryerje edhe pse të gjitha provat relevante tregojnë se ai ka qenë vetëm ndihmës. I akuzuari M. K. tradhtohet edhe nga ekspertët mjekësor të cilët e nxjerrin një ekspertizë skandaloze dhe qesharake. Diagnozën e kanë dhënë vetëm në bazë të deklaratës 5 minutëshe në institutin e tyre. Sipas bindjes së mbrojtësit kjo ekspertizë është dashtë të mbështet në burime shkencore siç është, citohet: “Cilat analiza do të bëhen me rastin e ekspertimit janë në faqen 173 të librit shkencor - Psikopatologjia Gjyqësore - nga autori Sllobodan Loga”. Në këtë libër thuhet se diagnoza e retardimit mental caktohet në bazë të analizave psikiatrike, fizikale, psikologjike dhe laboratorike, po ashtu duke i marr edhe analizat tjera shoqërore duke pyetur familjarët, shoqërinë apo ndonjë nga edukuesit të pacientit. Të njëjtat fakte përmenden edhe në faqen 54 të librit “Psikiatria Ligjore” të autorit Nazim Prishtina. Mbrojtja po ashtu theksoj se prokuroria e shtetit nuk ka përdor asnjë masë e fshehtë të hetimit të cilën e mundëson neni 90 par.1 pika 1 të KPPK, të cilat hetime prokurori ka mundur të shfrytëzoj për zbardhjen në tërësi të këtij rasti, pasi që do të ndikonte tek të dëmtuarit si nga ana morale ashtu edhe nga ana financiare, sepse po të ishin të akuzuar edhe personat tjetër, pala e dëmtuar shumë më lehtë në procedurë civile do të realizonte shumën e dëmit. Duke u mbështetur në nenin 7 par.2 të KPPK, prokuroria ka bërë shkelje të vazhdueshme të këtij parimit, sepse nuk ka marr asnjë provë që shkon në favor të akuzuarit edhe pse i njëjti është munduar që të ndihmoj jo vetëm për këtë veprë por edhe për veprat tjera të cilat tani i përzihen dhe nuk e din se kur, ku dhe cilën veprë e ka kryer. Duke u nisur nga parimi indubioproreo, propozoi gjykatës që t’u fal besimin deklaratës dhënë në gjykatë e jo deklaratave të tjera të cilat nuk përputhen me provat materiale. Sipas të lartë cekurave dhe deklaratës së dhënë në gjykatë i akuzuari duhet të gjykohet sipas neni 33 të KPK, ku parashihet institucioni i ndihmës në kryerjen e veprës penale. I akuzuari duke bërë roje i ka dhënë vetëm ndihmë fizike kryesve të veprës penale dhe ky veprim konsiderohet ndihmë dhe jo bashkëkryerje siç pretendon aktakuza. Po ashtu i propozoi gjykatës gjatë matjes së dënimit ndaj të akuzuarit Mërgim Kryeziu të bazohet me nenin 73 par.3 pika 6 e 7 të KPK, ku parashihen si rrethana lehtësuese: pranimi i fajësisë, rrethanat personale të kryerjes dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale. Mbrojtja në vazhdim theksoj se i akuzuari ka pak ngecje në zhvillimin mendor, sepse në gjykatë nuk e ka ditur datën e lindjes, nuk ka ditur mbiemrin e dajallarëve, nuk ka dashur të lirohet nga paraburgimi, ashtu që ne si shoqëri të gjithë duhet të ndihmojmë të akuzuarin, sepse shumë lehtë me një përkujdesje të shtuar trajtim psikologjik dhe psikiatrik mund të bëhet person që mund të kontribuojë në shoqëri, në të kundërtën nëse dërgohet në burg do të ndikohet nga të tjerët dhe nuk do të arrihet qëllimi i risocializimit i cili mund të shkaktoj dëme shumë më të mëdha. Andaj

gjykatës i propozoi që i akuzuari të lëshohet në liri dhe të detyrohet në trajtim të detyrueshëm psikiatrik. Në fjalën përfundimtare i akuzuari M. K. e mbështeti fjalët e mbrojtësit dhe nuk pati asgjë për të shtuar.

Mbrojtësi i akuzuarit A. G. – Avokat D. M. në fjalën përfundimtare theksoj se i akuzuari A. G., sipas aktakuzës së Prokurori Themelore në Prizren, akuzohet se ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me 31 të KPK, në bazë të përshkrimit të gjendjes faktike si në aktakuzë. Në seancën e shqyrtimit fillestar i akuzuari nuk ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës dhe të njëjtën e ka mohuar në të gjitha fazat e procedurës, me rastin e marrjes në pyetje në polici dhe në prokurori. Në këtë gjykatë janë administruar provat dhe janë dëgjuar dëshmitarët të cilat janë propozuar nga ana e prokurorisë, gjithë kjo me qëllim që të vërtetohet gjendja faktike e përshkrimit të veprës si në aktakuzë. Në aktakuzën e prokurorisë emri i akuzuarit si kryes i kësaj veprë penale ka rrjedhë nga deklaratat e dhënë në procedurën parapenale si dhe në fazën hetimore këtu të akuzuarit M. K.. Sa i përket kohës dhe mënyrës së kryerjes së veprës penale, mbrojtja konsideron se gjatë shqyrtimit nuk janë vërtetuar, për faktin se në shkresat e lëndës gjinden deklaratat e ndryshme si nga dëmtuarit, pretendimet e prokurorisë dhe nga deklaratat e akuzuarit M. K.. Deklaratat e akuzuarit M. K. kinse veprën penale ka kryer së bashku me të akuzuarin A. G., janë të gjitha kundërthënëse në mes veti dhe asnjëra nuk gjason me faktin dhe nuk përputhen në mes veti, me përshkrimin e veprës si në aktakuzë. Këtë vepër nuk e ka kryer A. G., kjo është vërtetuar në bazë deklaratave të dëshmitarëve të cilët janë dëgjuar në këtë gjykatë, po ashtu edhe pretendimet e mbrojtjes sa i përket vërtetimit të alibisë, të njëjtat janë vërtetuar me dëgjimin e dëshmitarëve të cilët janë propozuar nga mbrojtja. Të dëmtuarit gjatë dhënies së deklaratës në gjykatë nuk kanë thënë se e kanë parë A. G. që të ketë kryer këtë vepër. Dhe me asnjë provë tjetër nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer këtë veprën penale me të cilën akuzohet sipas prokurorisë. Pasi që jemi në një situatë ku i akuzuari involvohet vetëm mbi bazën e deklaratës së akuzuarit M. K., edhe sikur kjo deklaratë të jetë e vërtetë, nuk kemi ndonjë provë që do të vërteton të njëjtën dhe në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 262 të KPPK, gjykata të akuzuarin A. G. nuk e shpall fajtor vetëm me një provë. Andaj pas përfundimit të këtij gjykimi të tej zgjatur i propozoi gjykatës që të akuzuarit A. G., në kuptim të diapozitiv të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPPK të shqiptoj aktgjykim lirues, po ashtu edhe të lirohet nga paraburgimi. I akuzuari A. G. në fjalën përfundimtare theksoj se e përkrah fjalët e mbrojtësit dhe nuk ka asgjë për të shtuar.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Të akuzuarit M. K. dhe A. G., një kohë relativisht të gjatë njihen në mes veti, janë shokë të cilët shoqërohen dhe dalin bashkë, me ç'rast edhe ditën kritike në orët e pasditës kanë arritur marrëveshje që të takohen. Të njëjtit janë takuar në Lagjen te Shkolla Fillore "A. F." dhe më pas kanë vazhduar rrugën në drejtim të L. A.. Ditën kritike me datë 14.10.2016 derisa i dëmtuarit M. N. së bashku me anëtarët tjerë të familjes, kanë qenë në gosti tek kusherinjtë në fshatin L. e H. Komuna e Prizrenit, ndërsa e dëmtuara Z. N. pasi që kthehet nga puna, pas bisedës telefonike me familjarët, dikur rreth orës 18:00 ka shkuar në shëpinë e dajallarëve ku ka qëndruar shkurt dhe ka prituri ardhjen e anëtarëve të familjes, pasi që nuk ka pasur çelsin e shtëpisë. Në këtë interval kohor derisa në shtëpinë e dëmtuarve nuk ka qenë askush, të akuzuarit M. K. dhe A. G. me marrëveshje paraprake e shfrytëzojnë momentin e përshtatshëm, mosprezencën e dëmtuarve dhe anëtarëve tjerë të familjes, rreth orës 18:00 në Prizren – L. A. në shtëpinë e cila gjendet në rrugën ... pronë e dëmtuarve Z. N. dhe M. N., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete të pasurisë së huaj, të njëjtit e kapërcejnë murrin e oborit të shtëpisë e cila është përafërsisht 2 metra lartë dhe hynë brenada. Të akuzuarit bashkarisht shkojnë në oborrin e pasëm të shtëpisë dhe me shufër hekuri

– mjet i fort i përshtatshëm për hapjen e hapësirave të mbyllura e thyejn dritaren e katit të poshtëm ku është kuzhina dhe depërtojnë mbrenda. Pasi që hyjnë në katin e parë, të akuzuarit drejt hypin në katin e dytë të shtëpisë dhe fillojnë të demolojnë dhomat e fjetjes, e thyejnë derën e dhomës së fjetjes të dëmtuarës Z. N. dhe nga koferi marin stoli ari të cilët i ka pasur e dëmtuara në ruajtje, pasi që stolit i takonin motrës së saj e cila jeton në Republikën e Gjermanis. Po në këtë kat e demolojnë edhe dhomën e fjetjes të dëmtuarit M. N. dhe nga aty marin stolit e arit të cilët i takojnë bashkëshortes së tij. Të akuzuarit me qëllim të përvetsimit të kundërligjshëm për vete merrin pasurinë e luajtshme të dëmtuarve ashtu që nga aty marin gjësende të vlefshme stoli ari dhe atë: 7 (shtatë) unaza, 5 (pesë) putlia, 6 (gjashtë) lira, 5 (pesë) hallka dore, 4 (katër) zinxhirë të trashë, 1 (një) zinxhir në gjatësi prej 2 metra, 3 (tri) qafore, 2 (dy) zinxhirë të dorës, 2 (dy) unaza, 1 (një) qafore. Si pasojë e këtyre veprimeve të akuzuarit bashkarisht kanë shaktuar dëm të konsiderueshëm material. Nga kjo del se në veprimet e akuzuarve M. K. dhe A. G. më afër të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi, formohen të gjitha elementet e veprës penale e kryer në bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat: deklaratat e dëmtuarve Z. N. dhe M. N., janë lexuar provat materiale të cilat rrjedhin nga kallëzimi penal me numër 2016-GA-2589 të datës 18.11.2016, deklarata e akuzuarit M. K. dhënë para zyrtarëve të policisë në cilësinë e dyshuarit me datë 18.11.2016, deklarata e akuzuarit A. G. dhënë para zyrtarëve të policisë në cilësinë e dyshuarit me datë 18.11.2016, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes punuar nga njësia e forenzikës me numër të rastit 2016-RVK-475 të datës 14.10.2016, raporti i ekzaminimit nga njësia AFIS në Prizren me numër të rastit 2016-GA-2589, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve dhe është bërë shikimi në foto dokumentacion. Po ashtu në procedurën e provave janë administruar edhe provat e propozuar nga ana e mbrojtjes: në cilësinë e ekspertit është dëgjuar anëtari i ekipit të ekspertëve – Institutit të Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë Dr.V. B. – Psikiatër, janë dëgjuar dëshmitarët J. G. dhe F. K. si dhe është lexuar ekspertiza për shëndetin mendor të akuzuarit M. K. punuar nga ekipi i ekspertëve të Klinikës Universitare – Klinika e Neuropsikiatrisë të datës 10.02.2017.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike ka vërtetuar nga deklaratat e akuzuarit M. K. i cili prej fillimit të procedurës siç është deklarata e dhënë para zyrtarëve të policisë në prezencën e mbrojtësit, deklarata gjatë marrjes në pyetje në procedurën hetimore para prokurorit të shtetit me datë 25.11.2016, ku ka qenë prezent mbrojtësi dhe deklarata e tij në shqyrtimin gjyqësor gjatë marrjes në pyetje, del se deponimet e akuzuarit sa i për ketë vendit të ngjarjes, mënyrës së kryerjes së veprës penale dhe qëllimit, janë plotësisht në pajtim e njëri tjetrin. Këto deklarata të cilat për gjykatën janë prova të pranueshme dhe të cilat nga përshkrimi i veprimeve të ndërmarra nga ana e akuzuarve dhe përshkrimit të ambientit dhe vendit të ngjarjes nga ana e dëmtuarve dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit, e plotësojnë të njëjtat dhe plotësohen në mes veti. Këto deponime si prova argumentohen edhe me provat materiale siç është raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes punuar nga njësia e forenzikës me numër të rastit 2016-RVK-475 të datës 14.10.2016 dhe me foto dokumentacionin.

I akuzuari A. G. në tërësi kundërshtoi aktakuzën e prokurorit të shtetit dhe theksoi se nuk është fajtor për veprën penale e cila i vihet në barë. Nga deponimet e akuzuarit dhënë para zyrtarëve të policisë dhe në procedurën paraprake para prokurorit të shtetit thekson se ditën kritike në të cilën thirret aktakuza, nuk është takuar me të akuzuarin M. K., por ka qenë në fshatin P. Komuna e Prizrenit, duke punuar me vëllezërit e tij në shtëpitë ku kanë bërë instalimin për energji elektrike.

Në këto objekte ka punuar deri në ora 20:00 dhe pastaj është kthyer në shtëpi me qëllim që të pushoj. I akuzuari nuk mohon faktin se me të akuzuarin M. K. ka shoqëri një kohë relativisht të gjatë dhe kohë pas kohe takohen, por e kundërshton theksimet e akuzuarit M. K.. I akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor në momentin kur është dashtë të merret në pyetje nga ana e gjykatës dhe palëve në procedurë, në marrëveshje me mbrojtësin, i vetëdijshëm për veprimin e ndërmarrë, para gjykatës është deklaruar se kërkon të mbrohet në heshtje.

Gjykata pas administrimit të provave veç e veç dhe pas vlerësimit të tyre nuk ka pranuar mbrojtjen e akuzuarit A. G., me arsyetim se nuk është fajtor për veprën penale me të cilën ngarkohet, ngase ditën kritike kur ka ndodhur vjedhja në dëm të dëmtuarve Z. N. dhe M. N., saktësisht me datë 14.10.2016 rreth orës 18:00 ai nuk ka qenë në Prizren. Në kohën në të cilën thirret aktakuza, i akuzuari A. G. së bashku me vëllezërit e tij ka qenë në fshatin P. Komuna e Prizrenit, duke kryer punët rreth instalimit për energji elektrike. Gjykata nuk i kushtoj besim kësaj deklarate pasi që mbrojtja e këtillë nuk është e pranueshme dhe bindëse për gjykatën dhe se i akuzuari ka për qëllim që ti shmanget përgjegjësisë penale.

I akuzuari A. G. dhe mbrojtësi i tij gjatë tërë kohës janë thirr në vërtetimin dhe sigurimin e alibisë për të akuzuarin, me ç'rast gjykata në këtë drejtim ka dëgjuar dëshmitarët J. G. dhe F. K.. Gjatë shqyrtimit kryesor dëshmitari F. G. ka deklaruar se punon si ndërmarrës në punët e ndërtimitarisë të cilat i kryen në fshatin Z. të H., i cili varësisht prej vëllimit të punëve numri i punëtorëve ndryshon. Dëshmitari theksoj se në vitin 2016 po në këtë vend kanë qenë duke kryer punë në ndërtimin e vend strehimores për gjuetar, në mesin e të cilëve si punëtor ka qenë edhe i akuzuari A. G.. Puna, konkretisht orari i punës në këtë vend punim fillon në ora 06:30 minuta dhe zgjat gjer më ora 18:00. I akuzuari A. G. ditën kritike ka qenë në punë tek dëshmitari dhe ka punuar me orar të plotë, që nënkupton se ka punuar deri në ora 18:00, i cili me furgonin e tij si mjet transportues, pas kryerjes së punëve punëtorët transportohen deri në Prizren, rruga e cila zgjat 30 minuta. Dëshmitari radhës J. G. përndryshe vëllai i akuzuarit në deponimin e tij theksoj se vëllai i tij – i akuzuari A. G. pas kryerjes së punëve tek punëdhënësi i lartpërmendur, ditën kritike deri në orët e vona të natës i akuzuari vazhdoj punën me të në fshatin P. Komuna e Prizrenit, ku kanë kryer punët rreth instalimit të rrjetit për energji elektrike. Gjykata nuk i kushtoj besim deponimeve të këtyre dëshmitarëve me qëllim të sigurimit të alibisë për të akuzuarin A. G., pasi që strategjia e mbrojtjes gjatë shqyrtimit gjyqësor ka qenë e atillë, që bie ndesh me deklaratën e akuzuarit A. G. dhënë para zyrtarëve të policisë me datë 18.11.2016. Në këtë deklaratë i akuzuari mbrojtjen e tij ka drejtuar në sigurimin e alibisë duke precizuar se ka qenë në punë tek punëdhënësi D. K. pronar i firmës “P.” ku kanë shtruar ibercug dhe ka punuar deri në ora 21:00. Andaj gjykata mbrojtjes së tillë dhe dhënies së alibisë nga dëshmitarët e lartë përmendur nuk i kushtoj besim, pasi që është edhe në kundërshtim me provat të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, deklarata e dëmtuarve Z. N. dhe M. N., deklaratat e akuzuarit M. K. dhënë para zyrtarëve të policisë në cilësinë e dyshuarit me datë 18.11.2016, deklarata e vet të akuzuarit A. G. dhënë para zyrtarëve të policisë në cilësinë e dyshuarit me datë 18.11.2016, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes punuar nga njësia e forenzikës me numër të rastit 2016-RVK-475 të datës 14.10.2016, të cilat prova janë pjesë e shkresave të lëndës të cilat në tërësi dëshmojnë të kundërtën.

Pra nga shkresat e lëndës dhe nga të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor del se të akuzuarit momentin kritik kanë qenë bashkë dhe me marrëveshje paraprahe kanë caktuar vendtakimin dhe kanë zgjedhur kohën, kështu që bashkërisht të përgatitur për arritjen e qëllimeve të

veta, kanë shkuar në drejtim të L. A., ku është shtëpia e dëmtuarve Z. N. dhe M. N.. Të akuzuarit kanë njohur terrenin shumë mirë dhe paraprakisht janë organizuar, janë pajisur me mjet të përshtatshëm për hapjen e hapësirave të mbyllura dhe kanë zgjedhur kohën dhe mënyrën se si do të kryejnë veprimin kundërligjor, kjo nënkupton që kanë pritur që familjarët të dalin nga shtëpia dhe pastaj të depërtojnë brenda. Po ashtu me rëndësi për gjykatën është edhe fakti se të akuzuarit kanë njohur konfiguracionin e shtëpisë, sepse janë drejtuar në oborrin e pasme të shtëpisë dhe kanë thyer dritaren e kuzhinës, sepse kanë pasur më lehtë të përdorin forcë dhe të punojnë, pasi kjo pjesë e shtëpisë nuk shihet nga rruga kryesore, kështu edhe kanë eliminuar pengesat duke thyer dritaren e kuzhinës dhe me forcë kanë hyrë në katin e parë të shtëpisë së dëmtuarve, të njëjtit hyjnë brenda pa e prekur katin e parë, menjëherë shkojnë në katin e dytë nga dhomat e katit të dytë të shtëpisë duke demoluar orenditë dhe dyert e dhomave marrin gjësende të vlefshme me qëllim të përvetësimit të dobisë pasurore për vete.

Të gjitha këto fakte vërtetohen nga deklaratat e këtu të akuzuarit M. K., deponimet e dëmtuarve, raporti me shkrim i zyrtarit policor në këtë çështje penale dhe nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes punuar nga njësia e forenzikë. Këto dëshmi përputhen plotësisht me njëri tjetrin, sidomos fakti që e vërteton i akuzuari M. K. lidhur me përshkrimin e shtëpisë së dëmtuarve dhe lartësinë e murit të oborrit të shtëpisë, cilin kanë kapërcyer të akuzuarit, ku i njëjti në deklaratën dhënë para zyrtarit policor thekson se “murri ka qenë në lartësi prej 2 metra”, këtë fakt e vërteton edhe zyrtari policor në raportin e tij me shkrim. Po në këtë drejtim edhe vetë përshkrimi i veprimeve të ndërmarra brenda në shtëpi nga ana e akuzuarve si pasojë e cilave ka mbetur gjendja e demoluar e dhomave të katit të dytë të shtëpisë, të cilën e përshkruajnë edhe të dëmtuarit. Fakti tjetër që vërteton përgatitjen e akuzuarve për kryerjen e veprës penale është edhe veprimi i tyre brenda në shtëpinë e dëmtuarve, sepse ata kanë njohur mirë gjendjen materiale të personave në këtë shtëpi dhe rrethanat tjera që ndikojnë në kryerjen e veprës penale të vjedhjes, sepse të njëjtit nuk kanë demoluar fare katin e parë por kanë shkuar drejtpërdrejtë në katin e epërm ku kanë qenë dhomat e fjetjes të dëmtuarve, duke ditur se aty ka stoli ari. Edhe pse i akuzuari A. G. në deklaratën e tij dhënë në polici e prokurori por edhe para gjykatës është mbrojtur në heshtje, kjo tregon se i njëjtit dëshiron të shmanget nga përgjegjësia penale duke u mundur të krijojë alibi. Në këtë drejtim gjykata ka dëgjuar dëshmitarët J. G. dhe F. K. të cilët në deklaratat e tyre kanë qenë konfuzë dhe nuk kanë mundur të bindin gjykatën, pasi që një mori provash tjera të administruara nga ana e gjykatës dëshmojnë të kundërtën. Sa i përket deponimeve të akuzuarit M. K., gjykata i kushtoj besim edhe pse ka pasur ndryshime të vogla, por në esencë të gjitha deklaratat kanë qenë të njëjta, i akuzuari ndryshimet e tilla ka bërë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe qëllimi i tij ka qenë që gjykatën ta vë në dyshim gjatë vlerësimit të provave. Në këtë drejtim mbrojtësi i akuzuarit ka kërkuar dhe kryerjen e ekspertizës sa i përket shëndetit mendor të akuzuarit M. K., me qëllim të lirimit nga përgjegjësia penale vetë të akuzuarit dhe bashkëkryerësit – të akuzuarin A. G.. Por sipas ekspertizës së grupit të ekspertëve për shëndetin mendor të akuzuarit M. K., punuar nga ekipi i ekspertëve të Klinikës Universitare – Klinika e Neuropsikiatrisë me datë 10.02.2017, dëshmon se i akuzuari është i përgjegjshëm, nuk vuan nga çrregullimet e kualitetit psikotik, nuk ka prapambetje mendore, në momentin kritik, gjatë kryerjes së veprës penale aftësia e të kuptuarit dhe kontrollit të veprimeve ka qenë e ruajtur, ka aftësi për konsultim me personat tjerë dhe nuk janë gjetur elementet e natyrës psikike të cilat do të ndikonin në veliditetin e deklaratave të tij. Këtë qëndrim e mbron edhe eksperti anëtar i ekipit të ekspertëve – Institutit të Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë Dr. V. B. – Psikiatër, e cila në mënyrë të vendosur ka përshkruar konstatimet në ekspertizë, me arsyetim se ekspertiza është kryer me metodat të cilat janë të aplikueshme për institutin e forenzikës dhe janë marrë plotësisht në pajtim me ligjet e aplikueshme. Kështu gjykata

ka vërtetuar përgjegjësinë penale të akuzuarve, sepse të akuzuarit para se të kryejnë veprën penale të vjedhjes në momentin kritik, paraprakisht janë marrë veshë dhe janë përgatitur për një veprim të tillë duke e zgjedhur kohën, mjetet dhe vendin për kryerjen e veprimeve kundërligjore, ashtu që nga shtëpia e dëmtuarit duke e thyer hapësirat e mbyllura, prej nga kanë marrë gjësende me vlerë – stoli ari, me ç’rast kanë shkaktuar dëme materiale të konsiderueshme, të gjitha me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj, nga e cila rezulton se veprimet e këtilla kanë kryer me dashje direkte, sepse kanë qenë të vetëdijshëm për veprimet e veta dhe kanë dëshiruar kryerjen e saj dhe shkaktimit të pasojës. Pra në rastin konkret gjykata në këtë mënyrë edhe ka vërtetuar përgjegjësinë e tyre penale juridike.

Sa i përket provave të cilat janë administruar nga ana e gjykatës dhe atë: raporti i ekzaminimit nga njësia AFIS në Prizren me numër të rastit 2016-GA-2589, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, gjatë analizës së tyre nga ana e gjykatës, del se nga rezultatet e këtyre provave nuk kanë dalë konkludime të cilët do të ndihmonin rastin konkret. Prandaj edhe këto prova edhe pse janë administruar nga ana e gjykatës si të tilla janë pjesë e shkresave të lëndës dhe nuk do komentohen, pasi që në asnjë mënyrë nuk kanë ndikuar në këtë procedurë.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, në rastin konkret gjykata si rrethanë rënduese morri parasysh faktin se të akuzuarit M. K. dhe A. G. janë përsëritës i veprave penale të kësaj natyre, për të cilët kemi fakte se po në këtë gjykatë janë në zhvillim e sipër edhe disa procedura penale të kësaj natyre e që për gjykatën kjo konsiderohet si fakt shumë i rëndësishëm me çfarë edhe shihet karakteri i tyre personal, pra janë përsëritës, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarit gjykata morri parasysh faktin se kanë qenë të sjellshëm gjatë gjithë procedurës, mosha e re, gjendja e varfër ekonomike, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoi dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi, bindur se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tyre dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahen nga veprimet e tilla, me bindje se dënimi është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtor.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarve në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr.2652/2016 të datës 09.10.2017

**Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka**

**Gjyqtarja
Teuta Krusha**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimet, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.